

## **Kostot dhe ndikimi ekonomik që ka dhuna tek fëmijët (Përmbledhje)**

E botuar nga Instituti për Zhvillimin Jashtë Vendit, 2014. Autorë Paola Perezniето, Andres Montes, Solveig Routier dhe Lara Langston.

Krahas koston njerëzore që ka dhuna seksuale kundër fëmijëve, ajo ka edhe një kosto të lartë ekonomike në formën e uljes së produktivitetit dhe efektit tek shërbimet sociale. Në nivel botëror, çmohet se humbjet e produktivitetit për shkak të dhunës seksuale, fizike dhe psikologjike të fëmijëve janë të barazvlefshme me 3% dhe 8% GDP botërore. Kjo shifër është përlogaritur duke vlerësuar dominimin e dhunës kundër fëmijëve dhe diferencës së rrogave midis punonjësve që mbarojnë studimet dhe atyre që nuk i mbarojnë si dhe llogariten humbjet e produktivitetit/të ardhurave për shkak të humbjes së shkollimit si rezultat i përvojës së dhunës në fëmijëri. Gama (midis 3% dhe 8%) përcaktohet nëpërmjet dallimit të intervaleve që rezultojnë nga korrelacioni midis kostove të vlerësuara të dhunës kundër fëmijëve nga një anë dhe variabëlave që lidhen me to si braktisja e shkollës fillore, produkti për punëtor, përqindja e fëmijëve që përjetojnë dhunën dhe përqindja e fëmijëve që punojnë nga ana tjetër. Duke pasur parasysh këto kosto, rritja e programeve për parandalimin e dhunës nuk është e nevojshme vetëm për mirëqenien e fëmijëve, por edhe redukton kostot.

Dhuna seksuale, fizike dhe psikologjike kundër fëmijëve shpesh ka efekte që zgjasin gjithë jetën dhe ndër breza tek shëndeti i fëmijëve, edukimi dhe cilësia e jetës. Në nivel botëror, mendohet se ka 150 milion vajza dhe 73 milion djem nën 18 vjeç që mendohet se kanë përjetuar dhunë seksuale. 50% e viktimave nga të gjitha sulmet seksuale në gjithë botën janë fëmijë të gjinisë femërore dhe rreth një milion fëmijë shfrytëzohen për seks komercial çdo vit. Efektet mund të përfshijnë dëmtime fizike, sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe infeksione, çrregullime të shëndetit mendor dhe shtatzëni tek fëmijët. Këta faktorë shpesh ndikojnë tek shkollimi i fëmijëve që sjell drejtëpërdrejt të ardhura më të ulta në të ardhmen si për individët e prekur dhe për ekonominë në tërësi. Ky efekt si shkak i përvojës së dhunës seksuale në shkollë, ku tek shtetet me të ardhura të ulta, është një nga faktorët kryesorë pse braktisin shkollën femrat. Vlerësohet se kostot ekonomike të shtatzënisë tek fëmijët nga shtetet e varfëra variojnë nga 1% deri tek 30% e GDP për gjatë gjithë jetës së vajzës.

Megjithë rritjen e njohjes së rëndësisë së parandalimit të dhunës kundër fëmijëve, nivelet e shpenzimeve të qeverisë në këtë fushë mbeten të ulëta ose pa dokumentuara. Megjithatë, studimet e rasteve tregojnë se programet e parandalimit mund të jetë edhe të suksesshme dhe me pak kosto duke pasur parasysh kostot e larta ekonomike të shkaktuara nga dhuna ndaj fëmijëve. Shembujt përfshijnë ndërhyrjet që ofrojnë trajnimin e aftësisimit për jetën dhe edukimin seksual të vajzave vulnerabël në varfëri, si një mënyrë për parandalimin e abuzimit seksual. Kjo tregon se programet e parandalimit duhet të rriten për të prekur një një pjesë

më të madhe të popullsisë. Është e nevojshme për më shumë hulumtime, sidomos për dhunën ndaj fëmijëve tek vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, për të ndihmuar qeveritë të vendosin përparësitë për financim në këtë fushë.

*Përmbledhje e përgatitur nga Katarina Obermajer, Platforma për Mbrojtjen e Fëmijëve për Evropën Juglindore, 2015.*